



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:052613

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06552054

C-III-17-0185

Paditësit: S1 B,S2 B,N B dhe I B të gjithë nga fshati L, Komuna e Prizrenit.

Kundër

Pala e paditur: KBI “Progres Export” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji në përbërje nga gjyqtari kryesues Asllan Krasniqi dhe gjyqtarët anëtarë;Hasim Sogojeva dhe Murat Hulaj,në seancën dëgjimore publike të datës 05.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M P Ë R S H K A K T Ë M O S P A R A Q I T J E S

Hedhet poshtë kërkesëpadia e paditësve: S1 B,S2 B,N B dhe I B të gjithë nga fshati L, Komuna e Prizrenit e parashtruar kundër KBI “Progres Export” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me të cilën kanë kërkuar që të anulohet kontrata e shitblerjes me numër ., e datës ., si dhe kthimin në shfrytëzim të pa penguar të pronës-ngastrës me numër ., në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, klasa e IV-vendi i quajtur T P dhe ngastrës kadastrale me numër ., në sipërfaqe prej 0.41,00 ha vendi i quajtur K, fleta poseduese me nr., Zyra Kadastrale Prizren.

Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësit S1 B,S2 B,N B dhe I B të gjithë nga fshati L, Komuna e Prizrenit kanë parashtruar padi kundër të paditurës KBI “Progres Export” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, përmes të cilës i kanë propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të lëndës kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar. Me kërkesëpadi kanë propozuar që të anulohet kontrata e shitblerjes me numër ., e datës ., e lidhur në mes të paditësve dhe të paditurve.

Po ashtu i ka propozuar gjykatës kthimin në shfrytëzim të pa penguar të pronës- ngastrës me nr., në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, klasa e IV-vendi i quajtur T P dhe ngastrës kadastrale me nr., në

sipërfaqe prej 0.41,00 ha vendi i quajtur K, fleta poseduese me nr., Zyra Kadastrale Prizren, duke i kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës ka ftuar me ftesa të rregullta palët ndërgjyqëse për të prezantuar në seancën e datës;02.12.2024 dhe ka vlerësuar se sipas shënimeve të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësit i kanë pranuar ato me datën 31.10.2024, mirëpo në seancë nuk kanë prezantuar të njëjtit dhe mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

I autorizuari i palës së paditur në seancën e mbajtur me datën 02.12.2024 pas njoftimit nga gjykata se palët paditëse nuk prezantojnë në këtë seancë edhe pse ftesat i kanë pranuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen e tyre në këtë seancë nuk e kanë arsyetuar, i ka propozuar gjykatës që të merr Aktgjykim për shkak të mosparaqitjes konform nenit 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palës së paditur bazuar në dispozitën e nenit 58 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086 duke vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë me shkrim në afatin kohor prej 30 ditëve për prishjen e këtij aktgjykimi Gjykatës së shkallës së parë e cila e ka marrë këtë aktgjykim, ndërsa nëse kjo gjykatë e refuzon kërkesën e palës paditëse me aktvendim, atëherë i njëjti mund t'i drejtohet me ankesë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Asllan Krasniqi, Gjyqtar kryesues

Hasim Sogojeva, Gjyqtar anëtar dhe

Muart Hulaj, Gjyqtar anëtar